



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 200/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Alfa I”-Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Business Pro” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me valvola dhe filtera” me nr. të prok: Termokos sh.a, -19-038-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Termokos sh.a, më datë: 17.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Alfa I” - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me valvola dhe filtera” me nr. të prok: Termokos sh.a, -19-038-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Termokos sh.a.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me valvola dhe filtera” me nr. të prok: Termokos.sh.a-19-038-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Termokos sh.a.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Alfa I” - Lipjan, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Alfa I” - Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.03.2020 me nr. 200/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me valvola dhe filtera” me nr. të prok: Termoskos.sha-19-038-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Termokos sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.04.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i përgjegjshëm, pasi që edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin të dt.14.02.2020 e ka eliminuar me arsyen si në vijim: "Sipas komisionit të vlerësimit të tenderit OE “Business Pro” SH.P.K, prepozicionet 1-10 në ofertën e tij ka ofruar katalogun FAF6000 për valvola Ovale ka ofruar tipin F4 (valvola pa funde të vazhduara), ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qenë dimensionin i tipit F5 (me funde të vazhduara për izolim), ndërsa valvolat e ofruara në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë", eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Konstatimi i OE ankues se valvolat ovale të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nga pozicioni 1-10 nuk janë në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, sepse në dosje është kërkuar valvola ovale me “funde të vazhduara”, ndërsa OE fitues ka ofruar “Valvola pa funde të vazhduara”, për mendimin e ekspertit shqyrtues është konstatim i pa saktë.

Në përshkrimin e specifikimit teknik për Valvolat “ovale”, askund nuk shkruan që valvolat duhet të kenë

“Funde të vazhduara”. Në specifikim teknik është kërkuar që Valvolat sferike duhet të kenë “funde të vazhduara”, e jo valvolat ovale siç e thekson OE ankues. Prandaj, ky pretendim ankimorë është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se arsyet e AK-se për eliminimin tonë se është kërkuar temperatura të jetë 130 gradë ndërsa ju keni ofruar temperaturën prej 70 gradë, nuk qëndron dhe është diskriminuese për ne si OE, sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, dhe për këtë arsye kemi edhe deklaratën e prodhuesit ku mundet të shihet qartë se prodhuesi në fjalë prodhon edhe materiale me temperaturë 130 gradë.

Eksperti shqyrtues ka këtë mendim: në katalogët e ofruara me ofertë të OE ankues janë ofruar materialet me temperaturë 70 gradë që është më e vogël se që është kërkuar në specifikimin teknik të dosjes së tenderit, që ka qenë 130 gradë. Mirëpo, OE ankues ka ofruar edhe një deklaratë të prodhuesit “Polix” nga Sllovenia që thekson se punon materiale edhe në temperatura 130 gradë.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues, kjo deklaratë e prodhuesit të OE ankues është dashur të pranohet. Megjithatë, kjo nuk do të kishte ndonjë efekt sepse OE ankues ka ofertë me çmim më të lartë rreth 4000 € se oferta e OE të rekomanduar. Marrë në përgjithësi ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues “Alfa I” – Lipjan, të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me valvola dhe filtera” me nr. të prok: NP Termoskos.sha-19-038-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Termokos sh.a.

Autoriteti Kontraktues, nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, më datë 10.04.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa

e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "Alfa I"-Lipjan se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili është i papërgjegjshëm, pasi që edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin të dt.14.02.2020 e ka eliminuar të njëjtin me arsyen si në vijim: "Sipas komisionit të vlerësimit të tenderit OE "Business Pro" SH.P.K, për pozicionet 1-10 në ofertën e tij ka ofruar katalogun FAF6000 për valvola Ovale ka ofruar tipin F4 (valvola pa funde të vazhduara), ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qenë dimensionin i tipit F5 (me funde të vazhduara për izolim). Më tej, OE ankues shton se valvolat e ofruara në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se konstatimi i OE ankues se valvolat ovale të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nga pozicioni 1-10 nuk janë në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, sepse në dosje është kërkuar valvola ovale me "funde të vazhduara", ndërsa OE fitues ka ofruar "Valvola pa funde të vazhduara", është konstatim i pa saktë për faktin se në përshkrimin e specifikimit teknik për Valvolat "ovale", askund nuk shkruan që valvolat duhet të kenë "Funde të vazhduara". Në specifikim teknik është kërkuar që Valvolat sferike duhet të kenë "funde të vazhduara", e jo valvolat ovale siç e thekson OE ankues. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "Alfa I"-Lipjan se autoriteti kontraktues e ka eliminuar OE ankues pa të drejt me arsyetimin se "është kërkuar temperatura të jetë 130 gradë ndërsa ju keni ofruar temperaturën prej 70 gradë", ky arsyetim i AK-së nuk qëndron dhe është diskriminuese për ne si OE, sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, dhe për këtë arsye kemi edhe deklaratën e prodhuesit ku mundet të shihet qartë se prodhuesi në fjalë prodhon edhe materiale me temperaturë 130 gradë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në katalogët e ofruara me ofertë të OE ankues janë ofruar materialet me temperaturë 70 gradë që është më e vogël se që është kërkuar në specifikimin teknik të dosjes së tenderit, që ka qenë 130 gradë. Mirëpo, OE ankues ka ofruar edhe një deklaratë të prodhuesit "Polix" nga Sllovenia, që thekson se ky prodhues punon materiale edhe në temperatura 130 gradë. Andaj, kjo deklaratë e prodhuesit të OE ankues është dashur të pranohet. Megjithatë, kjo nuk do të kishte ndonjë efekt sepse OE ankues ka ofertë me çmim më të lartë rreth 4000 € se oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, në përgjithësi ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Po ashtu, AK ka pasur në konsideratë edhe nenin 60 të

LPP-së për shkak se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka pasur ofertën me çmimin më të lirë, dhe njëherit ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PAÇARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "Termokos sh.a",

1x1 OE - "Alfa I" - Lipjan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.